

INAUGURIMI I GJIMNAZIT KLASIK "LOYOLA"



Një gjimnaz klasik i udhëhequr nga priftërinjtë Jezuitë, tanimë është bërë realitet. Më 16 prill 2005 u vu gurthemeli i saj, ndërsa pas dy viteve punë intensive ajo u kompletua dhe tani prët nxënësit e vet.

Në krye të këtij projekti, që nga fillimi ishte at Walter Happel SJ, anëtar Provincës Jezuite Gjermane. Ajo u themelua më 3.11.2003, me emrin - Association Loyola-Gymnasium. Tre themeluesit e shoqatës qenë at Walter Happel SJ (tashmë drejtor ekzekutiv), Gjon Alijaj dhe Pal Bala (këshilltar ligjor).

Nga këto ndodhi dhe të mira të cilat na erdhën nga të gjitha institucionet qeveritare dhe jo- qeveritare, bashkëpunorët, KFOR-i gjerman, donatorët, kompanitë, nxënësit, prindërit, edukatorët,

mësimdhënësit, stafi ynë i shkollës, arriti t'i bëjë përgatitjet në mënyrë që më 16 prill 2007, të festojmë dyvjetorin e vënies së gurthemelit të shkollës dhe përfundimin e objektit tonë me konvikte, shkollë dhe terene sportive. Në këtë kremte të madhe të sukseseve tona, morën pjesë bashkëpunorët tanë, pa të cilët, kjo ëndërr e jona, s'do të ishte realizuar. Në masën e madhe të mysafirëve, ishin edhe imzot Dodë Gjergji, Nunci Apostolik. Sbarbaro, Arqipeshkvi Hoçevar, imzot Zef Gashi, imzot Lucjan Avgustini, Joachim Ruecker, Gjenerali Kather e shumë përfaqësues të brigadave, fëmijë nga shkollat fqinje dhe besimtarë e klerikë të ndryshëm. Atë ditë u shfaq para mysafirëve tanë, një program i përgatitur nga nxënësit dhe arsimtarët, ku u këndua,

u vallëzua dhe u mbajt mësim demonstrues nëpër klasa e laboratore të veçanta.

Kjo shkollë, tani ka 318 nxënës, prej tyre 92 në konvikt, ndërsa të tjerët udhëtojnë nga Prizreni dhe rrethina. Shkolla ka konviktin e veçantë për vajza dhe për djem. Ajo ka terrenet sportive, labororet, klasat e mësimit dhe menzën, një kopsht të bukur me pemë ende të njoma, gjithashtu edhe një amfiteatër të bukur. Shkolla udhëhiqet nga parimet themelore të edukatës bashkëkohore, ka konceptin e vet pedagogjik, rendin shkollor e Rregulloren e konviktit. Njeriu jeton për një të ardhme më të mirë të fëmijëve tyre dhe kjo shkollë mund t'u ofrojë nxënësve një vlerësim korrekt të njohurive dhe një shoqëri me të drejta të barabarta pa marr

parasysh kombësinë apo religionin. Kjo shkollë punon për të mirën e të gjithëve, për të mirën e të ardhmen e fëmijëve tanë, për një edukim që do t'u duhet gjatë gjithë jetës.

Këtë vit, pranojmë edhe klasat e 6 (të gjashta) dhe klasat e 10 (të dhjeta) . Provimi pranues për vitin e ri shkollor, do të jetë më 9 qershor dhe pagesa për një vit është 720 euro, ndërsa

2. 520 euro për shkollë dhe banim në konvikt. P'a vlen të investoni për të ardhmen e fëmijëve tuaj. Vizitoni web faqen tonë: www.alg-prizren.com

Përgatiti: Ligrida Laçi

Këndi i fëmijëve

Emrat e fituesve të kuizit të kaluar

1. David Bytyçi	kl.VIII-1
2. Federika Morina	kl.VII -2
3. Sabina Dushi	kl.VIII-1
4. Laura Mesula	kl.VII -2
5. Kristian Spaqi	kl.VII -1
6. Monika Kolaj	kl.VIII-1
7. Roza Morina	kl.VIII-1
8. Renata Bytyçi	kl.VII -1
9. Rajmond Berisha	kl.VII -2
10. Genita Kolaj	kl.VIII-1

Pyetjet e sakta

1. b. E themelon Eukaristinë
2. c. Juda
3. b. Pilati
4. c. 3 të pasditës
5. b. Ky njeri është Biri i Zotit
6. b. Në një varr të çelur në një gur
7. a. Në të tretën ditë
8. b. Dikush prej grave
9. b. Apostujve

Përgatiti: Amanda Shkoza

*Fituesit e numrit të kaluar do të shpërblehen me nga një libër
FJALORI BIBLIK*